



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 21.08.2024

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 39, datë 24.01.2024, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendin e pa plotësuar si më poshtë vijon :

➤ **SEKTORI I PROTOKOLLIT DHE ARKIVËS**
ARKIVIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë)

➤ **Detyrat kryesore:**

1. Organizon dhe sistemon dokumentacionin në arkivë në përputhje me ligjin e Drejtorisë së Arkivave.
2. Plotëson fletë daljet në momentin e daljes së dokumentave nga arkiva.
3. Hap dosje sipas pasqyrës emërtuese dhe sistemon gjatë gjithë vitit.
4. Mban proces- verbal me dokumentat dhe dosjet që hyjnë në arkivë.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Diplomë e nivelit “Bachelor” në Shkenca Shoqërore. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”;
- Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 26.08.2024, ora 16:30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL